

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI: “Riparim -mirëmbajtje sisteme ajri të vakumuar dhe komprimuar, tanker oksigjeni, rampa oksigjeni, linjat e pajisjet përkatëse” për nevoja të QSUNT.

Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Shërbime Mirëmbajtje dhe Riparimi: 50000000-5;

22,625,938.79 (njëzet e dy milionë e gjashtëqind e njëzet e pesë mijë e nëntëqind e tridhjetë e tetë pikë shtatëdhjetë e nëntë) **lekë pa TVSH ose 240,624.68** (dyqind e dyzet mijë e gjashtëqind e njëzet e katër pikë gjashtëdhjetë e tetë) **Euro pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a. ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 9 të DST.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 “Kriteret e kualifikimit” të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.*

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të marrëveshjes kuadër.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/b të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr. 7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, është vendosur me qëllim sigurimin e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi, si dhe AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të balanceve të viteve: (2023, 2024, 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivit dhe pasivit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivit dhe pasivit. Nëse kërkohen një ose dy balance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023“Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se:Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e balanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % e vlerës së fondit limit të marrëveshjes kuadër.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar kontratën, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licensë profesionale të vleshme, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore, për kategorinë:

NS12-A “Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit”

Shënim: Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktura dhe Energjisë/ministrisë kompetente, Republika e Shqipërisë. Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe Ligjin nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret e procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencën profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Duke vlerësuar që nëpërmjet NS12-A “Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit”, konsiderohet, montimi dhe mirëmbajtje ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve pneumatike..., Liçenca dhe kategoria, e

përcaktuar si kriter është në përputhje dhe lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës që do të prokurohet, fondin limit dhe cilësinë e shërbimit, që kërkohej të ofrohet nëpërmjet kësaj marrëveshje kuadër.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar stafin teknik, për realizimin e shërbimeve objekt prokurimi, sipas profileve të mëposhtme:

- a. të paktën 1 (një) inxhinier mekanik
- b. të paktën 1 (një) punonjës të kualifikuar për sisteme gazrash mjekësore
- c. të paktën 2 (dy) punonjës elektro-mekanike

Për punonjësin në pikën a, duhet të paraqitet:

- Diplomë përkatëse
- kontratë pune të vlefshme

Për punonjësin në pikën b, c duhet të paraqitet:

- kontratë pune të vlefshme
- dëshmi aftësie profesionale (të vlefshme), sipas Ligjit Nr.15/2017, "Mbi arsimin dhe formimin profesional", i ndryshuar/ dokument certifikimi/kualifikimi (të vlefshme)

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e specifikimeve teknike, grafikut të ekzekutimit të kontratës dhe specifikimeve teknike, hartuar nga AK.

Kërkesa për disponimin e të paktën 1 (një) punonjësi: inxhinier mekanik është vendosur duke marrë në konsideratë se sistemet, për të cilat do të kryhen shërbimet objekt prokurimi, përfshijnë kontroll mekanik të kompresorëve dhe pompave, analizë të presionit, rrjedhjeve dhe integritetit të rrjetit, mirëmbajtje të sistemeve të oksigjenit, vakumit dhe ajrit të kompresuar, procese të cilat kërkojnë njohuri të thelluara në mekanikë, termodinamikë, interpretim të parametrave teknikë dhe performancës së sistemit, mbikqyrje dhe validim profesional të ndërhyrjeve. Sa më sipër, inxhinieri mekanik është i domosdoshëm për garantimin e funksionimit të sigurtë dhe sipas standarteve të kërkuara, marrjen e vendimeve teknike në raste defektesh, optimizimin e performancës dhe parandalimin e dështimeve. Roli i inxhinierit mekanik është kyç për garantimin e funksionimit të sigurtë dhe të qëndrueshëm të sistemit.

Në proceset e shërbimeve objekt prokurimi përfshihen ndërhyrjet në sisteme oksigjeni (tanke, rampa, reduktorë, valvula sigurie), rrjete shpërndarjeje deri në pika terminale, kontroll rrjedhjesh dhe pastërtie, testime sipas standarteve për gazra mjekësorë. Këto sisteme janë kritike për jetën e pacientëve dhe kërkojnë njohuri specifike për instalimet e gazrave mjekësore, respektim rigoroz të standarteve të kërkuara, procedura të sigurtë për ndërhyrje në linja oksigjeni. Si rrjedhojë, punonjësi i kualifikuar për sisteme gazrash

mjekësore siguron eliminimin e rreziqeve (rrjedhje, ndotje, presion i gabuar, etj.), dhe funksionim të sigurtë në zonat kritike.

Punonjësit elektro-mekanikë janë të nevojshëm, duke qenë se shërbimet objekt prokurimi përfshijnë një volum të konsiderueshëm ndërhyrjesh si: kontroll dhe ndërrim filtrash, vajrash, valvulash, mirëmbajtje motorësh dhe sisteme monitorimi, kontroll rrjedhjesh dhe integritet rrjeti, ndërhyrje periodike (javore, mujore, 3 mujore, 6 mujore, vjetore), dhe kërkojnë punë të vazhdueshme, kombinim të aftësive elektrike dhe mekanike.

Numri minimal 2(dy) është kërkuar i tillë për mbulimin e gjithë volumit të shërbimeve, të cilat do të kryhen në kompleksin spitalor të QSUNT, i cili përbëhet nga 20 godina spitalore, si dhe për garantimin e reagimit emergjent, me qëllim për të mos shkaktuar ndërprerje apo mosfunksionim të sistemeve, pasi cdo vonesë mund të ketë pasoja direkte për sigurinë e jetës së pacientëve.

Për të gjitha sa më sipër, bazuar në natyrën teknike, komplekse dhe kritike të sistemeve, kërkesat për mirëmbajtje periodike dhe teste të përcaktuara në specifikimet teknike, natyrën kritike të shërbimit në mjedis spitalor, si dhe kërkesën për reagim emergjent dhe funksionim pa ndërprerje, kërkesa për punonjësit e vendosur në këtë kriter është në përputhje me objektin e prokurimit dhe përbën minimumin e nevojshëm për realizimin e sigurtë, cilësor dhe sipas standarteve të këtij shërbimi.

Ak ka përgjegjësi të sigurojë se shërbimi i mirëmbajtjes objekt prokurimi do të bëhet nga punonjës të kualifikuar për të shmangur riskun për dëmtime/ndërpreje apo mosfunksionim të sistemeve, të cilat mund të jenë shkak për cënimin e sigurisë së jetës së pacientëve.

AK ka përcaktuar që ofertuesi të disponojë stafin Teknik minimal të nevojshëm për realizimin e shërbimeve objekt prokurimi.

Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit shërben si provë/dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se është i pajisur me çertifikatë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, dhe të jetë e vlefshme, si më poshtë:

S SH EN ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

Çertifikata duhet të jetë e lëshuar nga organe të vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Standardi ISO 9001 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” është i nevojshëm për të garantuar që operatori ekonomik disponon një sistem të menaxhimit të cilësisë së standartizuar, i cili siguron planifikim, realizim, kontroll dhe dokumentim të të gjitha proceseve të mirëmbajtjes.

Disponimi i këtij standarti siguron që proceset që përbëjnë shërbimin objekt prokurimi (mirëmbajtja periodike, testimet dhe kontrollet e vazhdueshme, ndërhyrjet emergjente) janë të dokumentuara, ndiqen në mënyrë të standartizuar, dhe cilësia e kryerjes së tyre kontrollohet dhe përmirësohet vazhdimisht. Gjithashtu, ky standart ndikon në identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve, parandalimin e gabimeve operative dhe standartizimin e procedurave të sigurisë.

Kërkesa për disponimin e standartit ISO 9001 i jep Autoritetit Kontraktor sigurinë se kontrata do të zbatohet në mënyrë të qëndrueshme dhe të besueshme, është në funksion të sigurimit të cilësisë së shërbimit të ofruar, elementë hsumë të rëndësishëm për natyrën kritike të shërbimit objekt prokurimi.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë se merr përsipër realizimin e shërbimit objekt prokurimi, sipas kushteve të përcaktuara në specifikimet teknike, duke lënë infrastrukturën respektive në kushte të plota optimale pune.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Nëpërmjet këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor sigurohet që operatori ekonomik angazhohet që do të zbatojë të gjitha kërkesat e specifikimeve teknike, do të realizojë mirëmbajtjen parandaluese dhe riparuese sipas standarteve të kërkuara, dhe do të sigurojë funksionim të pandërprerë dhe optimal të sistemeve.

Ky angazhim është shumë i rëndësishëm pasi shërbimi lidhet me sistemet e oksigjenit, vakumin mjekësor dhe ajrin e kompresuar, mirëfunksionimi i të cilave është jetik për jetën e pacientëve. Nëpërmjet kësaj deklarate ofertuesi mer përgjegjësi të plotë për cilësinë e realizimit të shërbimeve, mbajtjen e sistemeve në kushte të sigurta pune, minimizimin e riskut të defekteve apo ndërprerjeve, dhe ndërhyrjen sipas procedurave të përcaktuara teknike dhe ligjore. Kjo është një garanci e cila ndikon drejtëpërdrejtë në sigurinë klinike dhe funksionimin e pandërprerë të sistemeve.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë se të gjitha materialet që do të përdoren për riparime dhe furnizim vendosje dhe që i nënshtrohen kërkesave të ligjit nr. 89/2014 “Për pajisjet mjekësore” i ndryshuar, duhet të jenë të regjistruara me certifikatë regjistrimi pranë “Agjensisë Kombëtare të Barnave dhe Paisjeve Mjekësore (AKBPM)” sipas parashikimeve të këtij ligji.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”....”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektivit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Shërbimi objekt prokurimi lidhet me mirëmbajtjen e sistemeve të gazrave mjekësore (oksigjen, vakum, ajër i kompresuar), të cilat përbëjnë infrastrukturë kritike spitalore dhe ndikojnë drejtëpërdrejtë në trajtimin e pacientëve. Në këtë kuadër, kërkesa për deklarimin e materialeve dhe pajisjeve që do të përdoren në riparime dhe/ose furnizim vendosje (kur është e aplikueshme) synon të sigurojë që këto pajisje të jenë të regjistruara dhe të autorizuar për tregtim, të certifikuara sipas standarteve përkatëse, dhe të shoqëruara me dokumentacionin përkatës teknik dhe ligjor. Regjistrimi siguron që të gjitha materialet dhe pajisjet përmbushin kushtet ligjore dhe rregullatore, duke garantuar sigurinë, funksionimin dhe përputhshmërinë e impianteve me standardet mjekësore dhe teknike, duke përmbushur kështu edhe detyrimin ligjor të përcaktuar në nenin 13 të Ligjit 89/2014. Kjo masë parandalon përdorimin e pajisjeve jo të autorizuar, duke mbrojtur shëndetin e pacientëve dhe stafin mjekësor, dhe siguron realizimin të sigurt dhe të qëndrueshëm të shërbimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike/termat e referencës dhe përlllogaritja e fondit limit janë përgatitur/hartuar/ përcjellë nga Autoriteti Kontraktor “Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim

të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike/termat e referencës janë pjesë e pandashme e DST.

Në dokumentacionin e përcjellë nga AK, rezulton si më poshtë:

Kompleksi spitalor i QSUT përbëhet nga 20 godina spitalore dhe teknike, ku funksionojnë shërbime kritike dhe komplekse si salla operacioni, reanimacione, urgjenca kirurgjikale dhe të sëmundjeve të brendshme, urgjenca infektive, neuro-kirurgjike dhe pediatrike, pavione të specialiteteve të ndryshme dhe laboratorë klinikë. Funksionimi i këtyre njësive të ndryshme varet në mënyrë absolute nga sistemet e ajrit të kompresuar, vakumuar dhe linjat e oksigjenit, të cilat furnizojnë me gazra mjekësorë të pastër dhe presion të qëndrueshëm pajisjet mjekësore dhe terminalalet e pacientëve. Çdo ndërprerje ose mosfunksionim i këtyre sistemeve mund të ketë pasoja direkte për sigurinë e jetës së pacientëve, veçanërisht në sallat e operacioneve, reanimacione dhe urgjencat kritike.

Për përcaktimin e nevojave reale për mirëmbajtje, si fillim u identifikuan dhe azhornua inventari i të gjitha njësive që kërkojnë shërbim: 30 kompresorë, 44 pompa vakumi, 8 rampa oksigjeni, si dhe rrjetin e gazrave mjekësorë deri tek pikat terminale (testaletat, sallat operative, pavionet, me prizat e daljes përkatëse) si dhe panelët qendrorë dhe panelet lokale.

Për hartimin e Specifikimeve Teknike dhe zërave të Preventivit Grupi i Punës u mbështet në:

- M.K të kaluar me nr. 215/21 prot., datë 10.06.2024, duke bërë ndryshimet në sasi të preventivuar, në bazë të inventarizimit aktual të këtyre sistemeve e pajisjeve si dhe gjendjes teknike aktuale të tyre nga stacionet qendrore deri tek pikat terminale (testaletat, sallat operative, pavionet, me prizat e daljes përkatëse).*
- Vitin e vënies në punë të cdo sistemi/pajisje, historikun e mirëmbajtjes dhe defekteve të shfaqura gjatë viteve, gjendjen teknike aktuale, pjesët e konsumuara/dëmtuara si dhe problematikat e konstatuara; si dhe nevojat reale për riparime sidomos për sistemet në godinat ekzistuese.*
- Manuala teknike të prodhuesit ku përcaktohen shërbimet e nevojshme të mirëmbajtjes periodike për të garantuar efikasitetin dhe siguri të sistemeve;*
- Normativat, standartet kombëtare dhe ndërkombëtare (europiane) si dhe kërkesat teknike që përcaktojnë kriteret për të garantuar sigurinë, efikasitetin dhe besueshmërinë e këtyre sistemeve, me vëmendje të veçantë në mjediset kritike siç janë spitalet.*
- Nevojat dhe parashikimet për pjesë konsumi si F.v. Vakumeter (set), F.v fluksimeter (set), Reduktor oksigjeni, F.v vazo vakumi, F.v. gota lagështuesi oksigjeni, etj., si pasojë e dëmtive gjatë punës në shërbim si dhe nevojave shtesë që mund të lindin për këto pjesë, gjatë transferimit të shërbimit të Kardiokirurgjisë dhe Kirurgjisë Vaskulare në godinën e rikonstruktuar, në të cilën nuk është parashikuar kompletimi i testetave me fluksimetra dhe vakumetra.*

Për secilën kategori, u përcaktuan shërbimet teknike të nevojshme sipas frekuencës së mirëmbajtjes: javore, mujore, 3-mujore, 6-mujore dhe vjetore. Këto shërbime përfshijnë kontroll vizual dhe funksional të rampave dhe pompave, matje presioni, testim të alarmit qendror dhe lokal, verifikim të valvulave zonale, inspektim të pikat terminale dhe testimin e integritetit të rrjetit.

Ky preventiv është i bazuar në praktikën spitalore dhe standartet ndërkombëtare ISO 8573 (ajri i kompresuar), ISO 7396-1 (linjat e gazrave mjekësorë) dhe ISO 9170-1 (njësi terminale për gazra mjekësorë të kompresuar dhe vakum), duke siguruar një plan të plotë dhe të dokumentuar që adreson sigurinë klinike, performancën optimale të pajisjeve dhe parandalimin e dështimeve të papritura. Për secilën frekuencë, u përllogaritën orët totale të punës për secilin sistem dhe njësitë e tij, duke përfshirë rampat, pompash, rrjetin, valvulat, terminalalet dhe panelët qendrorë. Kjo qasje siguron monitorim të detajuar dhe bazë të saktë teknike për planifikimin e resurseve teknike.

NJESIA E PROKURIMIT